4. Transport – Ky nivel merr te dhenen nga Session Layer dhe e pregadit per Network Layer. Ku siguron qe e dhena te dergohet pa errora. Dhe te dhenes i referohet me segment. Po ashtu segmentin e ndane ne pjese te vogla (nese segmenti eshte i madhe) dhe cdo pjese te ndare i vendos nga nje Sequence Number qe kur te mrrijne ne destinacion at'her te renditen ne menyre te duhur qe e dhena e arritur te shfaqet sikur e dhena qe eshte derguar pasi qe nese nuk mberrijne ne rregull at'her do te korruptohet(Nuk dmth qe nese keto pjese te vogla nisen me rend dhe ashtu do te mberrijne, per ate edhe vendosen keta numra identifikues). Ketu bejne pjese dy protokolet qe jane protokolet me te rendesishme (protokolet baze) ne Internet dhe ato jane TCP - Transmission Control Protocol dhe UDP - User Datagram Protocol.

3. Network – Ky nivel i merr informatat nga Transport Layer i pregadit dhe i dergon ne Data Link Layer. Ne kete nivel kontrollohen IP, Subnetet, Routes (routat) nga kjo kuptojm qe Routerat punojne deri ne Nivelin e 3-te. Po ashtu behet lidhja nga adresat logjike ne ato fizike, dhe cdo data(me data i referohet te dhenave sikur qe ishte segment ne Transport Layer) qe eshte i ndame ne pjese te vogla i vendoset informata (IP Adresa) qe te dije se ku duhet te shkoje. Ne kete nivel bene pjese ICMP Protokoli (qe perdoret per ping).

2. Data Link – Ky nivel merr informaten nga Network Layer, bene ndryshimet e nevojshme dhe ja dorzon Physical Layer. Ne kete nivel e dhena duhet te sigurohet qe do te mberrij ne

nga hapi ne hapë pa ndonje error. Po ashtu te dhenave(qe jane te ndara ne pjese te vogla) i vendoset nga nje ErrorCheck ID ku kur te arrin ne destinacion at'her kontrollohet se a ka pasur ndonje error, nese po at'her i dergon informate qe i tregon se kjo e dhene ka error dhe dergoje edhe nje here. Ketu kontrollohet MacAdresa dhe lidhe adresat fizike me ato logjike (ku I vendos seciles pakete te ndare nga nje informate source-destination macaddress). Njeri nga protokolet qe perdoret ketu eshte PPTP - Point-to-Point Tunneling Protocol qe perdoret per VPN dhe kontroton GRE Tunelet (i krijuar nga CISCO qe perdoret per krijimin e VPN point to point, lidhjen e router-ave duke perdorur IP - Internet Protocol)

1. Physical – Ky nivel e pranon informaten nga Data Link dhe e pregadit qe ajo informate te filloj rrugen e vet per ne destinacion. Informaten qe e merr nga niveli me larte (010101) e perkthen ne ne sinjalë te rrymes dhe eshte pergjegjese qe te kontrolloje se a ka ndonje error, nese gjithqka eshte ne rregull at'her kete informate e dergon ne NIC (Network Interface Card – qe eshte kartela e rrjetit) dhe ajo fillon transmetimin duke perdorur ndonjerin nga mediumet (baker (UTP), vale (Wireless), drite (Fiber)).

2.4 PROTOKOLLET

Që dy ose më shumë subjekte të mund të komunikojnë ndërmjet veti është e domosdoshme t'u përmbahen rregullave të caktuara. Se Çfarë do të jenë këto rregulla varet nga mënyra komunikimit. P.sh nëse bisedojnë dy policë – kujdestari përmes radiostacionit me lidhje duplekse, secili pjesëmarrës duhet të ketë kujdes kur dërgon mesazhin (duhet të vë ndërpresin në pozicionin dhënës) dhe kur pranon mesazh (atëherë ndërpresin e vendos në pozicionin për pranim).

Për bartjen e të dhënave nëpër rrjet duhet të ketë rregulla të caktuara që përsëriten. Ato duhet të njihen nga të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion dhe që të gjithë duhen t'u përmbahen atyre. Këto rregulla ndër të tjera përfshijnë mënyrat e vendosjes së lidhjes, mbajtjes, shkëputjes, formës në të cilën të dhënat barten, përcaktimin e prioritetit të bartjes së mesazheve etj.

Rregullat e sjelljeve të miratuara quhen **protokolle**. Protokollet mund të jenë :

- të parapara në gjitha situatat të cilat mund të ndodhin gjatë bartjes së të dhënave dhe
- procedura të caktuara për secilën situatë të sjelljes

në të kundërtën do të vije deri te ndërprerja e komunikimit pasi kompjuterët e ditëve të sotme nuk pranojnë çfarëdo dykuptimësi ose situatë të pa-definuar.

Le të shohim se si është i organizuar *softueri i rrjetës (komunikues)*. Ju kujtojmë se te rrjetat e para hardueri ishte primar në krahasim me softuerin e rrjetës. Tani situata ka ndryshuar, softueri i rrjetës gjithnjë e më shumë është zhvilluar kështu që përfitua në domethënie. Sot softueri i rrjetës është shumë i strukturuar.

Detyra e menaxhimit me rrjetë janë të strukturuar në të njëjtën mënyrë si dhe detyrat që duhet ti ekzekutoj sistemi operativë të kompjuterit bashkëkohorë. Sistemi operativ paraqet bashkësi të programeve të cilët ashtu janë të ndërtuar që të lehtëson përdorimin e harduerit. P.sh ndërprerjet gjenerohen në intervale të ndryshme gjatë punës së kompjuterit dhe ato duhet përpunuar- kjo është një prej detyrave të sistemit kompjuterik. Bartja e interfejsit të shfrytëzuesit ndërmjet diskut dhe kujtesës operative gjithashtu është detyrë që kryen sistemi operativ. Roli i sistemit operativ është që ta njoftoj shfrytëzuesin me dukjen e kompjuterit virtual i cili në njëfarë mënyre është më i mirë se kompjuteri fizikë. Sistemi operativ vendos në disponim makinën e cila ka shumë mundësi teknike.

Në të njëjtën mënyrë softueri i rrjetës respektivisht softueri komunikues ka për qëllim të lidhë programin shfrytëzues me rrjetën virtuale kompjuterike e cila ka shumë mundësi teknike se sa hardueri komunikues burim. Siç kem parë se mesazhi nga një kompjuter amë burim në një kompjuterë tjetër mund të bartet përmes rrjetës kompjuteristike nëpërmes njejve të ndryshme në formë të paketave. Kështu që komunikimi i rrjetës virtuale ka urdhëresën të nivelit “**dërgo këtë mesazh në. . .**”. megjithëkëtë mekanizmi i bartjeve të të dhënave është dukshëm më kompleks.

- Mesazhi duhet të ndahet në pakete
- Në secilin paket duhet futur kokën (headerin)
- Paken duhet sjellë në linjën komunikuese në të cilën bartet vargu i bitëve;
- Mund të paraqitet nevoja të bëhet modulimi ;
- Ndërmjet njejve duhet bëhet pranimi i paketave ;
- Duhet të testohet se me rastin e transmetimit ka ardhur te gabimi;
- Nyja paraprake në udhëtim duhet të jetë e vërtetuar. Etj.

Domethënë sistemi operativ duhet të kryej shumë punë.

Ngjashmëria e mëtutjeshme me sistemin operativë gjendet në idenë e **Shtresave ose niveleve**. **Bërthama** esistemit operativ zakonisht përbëhet prej softuerit për menaxhim të ndërprerjeve, administrimin e indikatorëve(flags) dhe proceseve transportuese. Një nivel i jashtëm përdor këto funksione në sistemin e administrimit me kujtesë (p.sh. mënyra e administrimit me **faqe** të kujtesës-**paging**). Kjo përdoret në nivelin tjetër të jashtëm në të cilin bëhet hyrja në kompjuter dhe dalja nga kompjuteri. Siç shohim për nga struktura sistemi operativ ngjan në **shtresat e qepës**. Softueri i rrjetës përbëhet në të njëjtën mënyrë.

Në rrjetën kompjuterike administrimi me komunikim është i organizuar në mënyrë hierarkike, d.m.th. i ndarë në nivele, dhe këto nivele janë të shtresuar ashtu që secili nivel ose siç zakonisht quhen shtresa përdor shtresën paraprake më të ulët. Me fjalë të tjera shtresat ndërmjet veti janë të pavarura pos se secila shtresë izolon shtresën nën vete nga shtresat më të larta. Për këtë arsye ndërrimet eventuale tekniko-teknologjike në një shtresë nuk ndikojnë në shtresa të tjera. Softueri i rrjetës duhet të jetë i strukturuar në të njëjtën mënyrë që të mund të me sukses të kryej detyrat e kërkuara.

Koncepti i organizimit shtresor të softuerit të rrjetit është ilustruar Në figurën 16. 8. Numri, përmbajtja dhe emrat e shtresave janë të ndryshme në rrjeta të ndryshme. Në figurën është treguar rrjeta fiktive me pesë shtresa.




Figure 5 Shtresat., Protokollet dhe Interfejsi

Shtresat peer-to-peer (të nivelit të njëjtë)

Tersit të cilat përfshijnë shtresa të caktuara në kompjuterë të ndryshëm quhen peer shtresa siç shihet në fig 16. 8 çiftet komunikojnë ndërmjet veti duke përdorur protokolle. Në të vërtet të dhënat nuk barten nga një shtresë n njërit kompjuterë në shtresën n të kompjuterit tjetër. Në vend të saj, secila shtresë dërgon të dhëna dhe informacione kontrolluese në shtresën drejtpërdrejt nën te përderisa të mos arrihet shtresa më e ultë. Në shtresën 1 është mediumi fizik në të cilën bëhet komunikimi i vërtet. Në fig 16. 8 komunikimi virtual është treguar me linja të ndërprera dhe lidhja fizike me të plota.

Interfejsi

Ndërmjet çifteve të shtresave fqinje ndodhet një interfejs. Interfejsi siguron se cilat operacione primitive dhe shërbime i ofron niveli i ultë nivelit të lartë. Kur të vendoset me rastin e projektimit të rrjetës se sa shtresa duhet ti ketë rrjeta dhe se çka do të bëjë secila shtresë, njëra prej detyrave më me rëndësi të definohet interfejsi ndërlidhës ndërmjet veti. Interfejsët duhet të mundësoj sa më sigurt këmbimin(ndërrimin) e implementimit ekzistues të llojit të dhënë një implementimi krejt tjetër fare (p.sh të gjitha linjat telefonike zëvendësohen me kanale satelitore) pasi e gjitha çka kërkohet prej implementimit të ri është që ajo në shtresën e sajë të lartë të ofroj plotësisht bashkësinë e shërbimeve të cilën e ofronte implementimi i vjetër.

Protokoll stek

Bashkësia e shtresave dhe protokolleve parqet **arkitekturën e rrjetës**. Specifikacioni i arkitekturës të rrjetës së dhënë duhet të përmbaj informacione të mjaftueshme ashtu që të mundet për secilën shtresë të shkruhet programi ose ta ndërtohet hardueri i cili korrekt realizon protokollin përkatës. Sipas kësaj, arkitektura e rrjetës nuk përmban specifikacionin e interfejsit dhe as implementimin detal pasi këto nuk janë nga jashtë makine të pashme, saktë janë të fshehur në brendi të kompjuterit. Çka më tutje nuk është e domosdoshme që interfejsët në të gjithë kompjuterët në rrjetë të jetë i njëjtë, është e mjaftueshme nën kushtin se secili kompjuterë korrekt të përdor protokollin e tija. Bashkësia e protokolleve të cilët përdoren në ndonjë sistem, një protokoll për shtresë quhen **protokoll stek(protocol Stack)**

Principi i komunikimit shumë shtresor do ta shpjegojmë me një shembull analog. Le ta vëzhgomë **Kinezin** i cili fletë vetëm **kinezisht** dhe **frëngjisht** dhe që ndodhet në **Athinë**. **Gazetari** i cili fletë **shqip** dhe **rusisht** dëshiron nga **Prishtina** të merr intervju nga **Kinezi**. Siç shihet pasi nuk flasin ndonjë gjuhë të përbashkët këto duhet të angazhojnë një përkthyes. Le të supozojmë se gazetari në Prishtinë dinë se **Kinezi** ka në disponim **përkthyesin** i cili fletë **greqisht** dhe **frëngjisht**, gjen **përkthyesin** që flet **shqip** dhe **greqisht**. Secili **përkthyes** angazhon nga ana e vetë **sekretarëshën** e cila do të shtypë, dërgon dhe pranon faksë. Këtu siç shihet kemi rastin e komunikimit **tre shtresor**. **Gazetari** dhe **intervjueri** paraqesin **shtresën 3, përkthyesit shtresën 2** dhe **sekretarëshat shtresën 1**. Analizojmë vetën një cikël të pyetjes dhe përgjigjjes;

Reporter dëshiron të shtroj pyetjen e parë **Kinezit**. Ky pyetjen e tij e thotë në **shqip** duke ia lënë **përkthyesit**. Në bazë të fig 16. 8, por duhet mbajjt llogari se tani është fjala për rrjetën tre shtresore dhe jo rrjeta pesë shtresore, shohim se gazetari pyetjen e tij ia lenë **përkthyesit** përmes **interfejit 2/3**. **Përkthyesi** përkthen pyetjen nga **shqip** në **greqisht**. Zgjedhja e gjuhës (në këtë rast greqisht) paraqet **protokollin e shtresës 2**. **Përkthyesi** përkthen mesazhin dhe ia dërgon **sekretarëshës** për qëllim të **dërgimit** në **Athinë**. Zgjedhja e mjeteve për bartje të mesazhit (pyetjeve), në këtë rast **faksi**, paraqet **protokoll të shtresës 1** d.m.th te **sekretarëshës**. **Sekretarëshës** dërgon faksin me pyetje përmes **interfejit 1/2 përkthyesit (shtresa 2)** i cili përkthen pyetjen

nga greqishtjanë frëngjisht dhe përmes interfejsit 2/3 ia lenë të intervjuuarit. Është e qartë se në të njëjtën mënyrë përgjigja e të intervjuuarit iu lehet reporterit.

Në këtë shembull duhet vërejtur që secili protokoll është plotësisht i pavarur nga protokollat e tjerë derisa të mos ndërroj interfejsi. **Përkthyesit** mundën sipas marrëveshjes të kalojnë nga greqishtja në turqisht por kjo nuk i ndërron interfejsin as me **shtresën 1** as me **shtresën 3**. Nëse **sekretarëshat**(shtresa 1) në vend të fakseve vendosin p.sh të përdorin postën elektronike kjo aspak nuk ndikon në shtresat e tjera.

Le të kthehemi në fig 16.8 respektivisht në modelin e rrjetës pesë shtresore. Le ta gjeneroj **shtresa 5 mesazhin M**. Komunikimi virtual realizohet direkt ndërmjet **shtresës 5** në kompjuterin dërgues dhe **shtresës 5** në kompjuterin pranues. Le të shohim se si zhvillohet komunikimi i vërtet (fig16.9)**Mesazhi M** për qëllim të transmetimit bartet në shtresën4. **Shtresa 4** futë kokën (headerin), të cilën e kemi shënuar me **K4**, në fillim të mesazhit për qëllim të identifikimit të mesazhit. Në **kokë** ndodhet informacioni udhëheqës(i kontrollit) në formë të një vargu të numrave e cila i mundëson shtresës 4, në kompjuterin e cak që mesazhi t'ju dërgohet në renditje korrekte. Si rrjedhim i kësaj mund të ndodhë që paketat, d.m.th elementet në të cilët mesazhi në shtresat e ulta është e zbërthyer, nuk arrijnë në cak sipas të njëjtës renditje sipas të cilës dhe janë emituar. Modifikim e tillë të mesazhit (d.m.th organizim e mesazhit me koka shtesë) në shtresa e 4-të e ndjek dhe shtresa 3. Në shumë rrjeta në **shtresën 4** nuk është i kufizuar madhësia e mesazhit i cili transmetohet. Ndërsaprotokollin **i shtresës 3** pothuajse në gjitha rrjetat gjithmonë është i kufizuar në madhësi maksimale të mesazhit të lejuar. Për këtë arsye **shtresa 3** duhet të ndajë në mesazhet e arritura në njësi më të vogla, pakete dhe se secilin paket futet **koka e shtresës 3** e shënuar me **K3**. Në. fig 16. 9 **mesazhi M** ndahet në dy pjesë : **M1** dhe **M2**. **Shtresa 3** vendosë se cila prej linjave dalëse përdoret dhe më pas i lëshon mesazhet në **shtresën 2**. **Shtresa 2** i jep(shton) secilit paket kokën (të shënuar me **K2**) dhe përfundon shënimi i shënuar (i shënuar me **H2**) dhe më pas mesazhin e rimodifikuar e kalon në shtresën 1 për qëllim të transmetimit fizik.




Figure 6 Rrjedhja fizike e informacioneve

Në kompjuterin marrës mesazhi lëvizë kah lart, ngashtresa 1, larë ka shtresat më të larta. Ku në secilën shtresë hiqet koka (header) përkatës. Duhet mbajtur mend se as një në kokë e cila i takon shtresave nën shtesën e **n**-të nuk kalon në shtesën e **n**-të.

Nuk duhet menduar se ndonjë problem detyrimisht të zgjidhet me një shtresë. Disa probleme janë prezentë në disa e bile dhe në të gjitha shtresat çka domethënë dhe zgjidhen në secilën shtresë. Do ta ilustrojmë këtë me disa shembuj:

- Secila shtresë duhet ta ketë një mekanizëm të identifikon dërguesin dhe marrësin. Duke e pasur parasysh se për rastin e përgjithshëm në rrjetë janë të lidhur numër i madh i kompjuterëve, nevojitet që procesi në një kompjuterë të specifikohet se me cilin ai donë të komunikoj. Për shkak të mundësisë të ekzistimit të shumë caqeve të mundshme natyrisht se është i nevojshëm ndonjë mënyrë e adresimit nëpër mes të cilit definohet caku(pranuesi) i dëshiruar.
- Në secilën shtresë është prezent problemi si të harmonizohen shpejtësitë e punës të pajisjeve dhënëse marrëse ashtu që të mundësohet që dërguesi i shpejtë ta mbroj me të dhëna pranuesi e ngadalshëm. Ekzistojnë zgjidhje të ndryshme, por të gjitha mund të grupohen në dy themelore. Në njërin rast përdoret lidhja e kundërt (riveprimi) nga marrësi deri te dhënësi përmes së cilës dërguesi (transmetuesi) lajmëron mbi gjendjen momentale të marrësit. Në rastin e dytë shpejtësia e pajisjes dhënëse është e kufizuar në shpejtësi bartëse të marruar veshë që më parë.
- Në shumë shtresa duhet zgjedhur dhe problemin i cili shkaktohet për atë se disa përpunime (procese) nuk mund të pranojnë mesazhe të gjatësisë arbitrare. Për këtë arsye duhet përdorur mekanizmi për ndarje, bartje dhe përsëri bashkimin e mesazhit. Megjithatë nëse proceset (përpunimi) kërkojnë që bartja e të dhënave të jetë në njësi të gjatësisë së vogla kështu që bartja është rob i secilës kësaj njësie është

joekonomike, atëherë disa këso njësi duhet të bashkohen në një mesazh dhe mesazhi i tillë i modifikuar të dërgohet në cak e cila pas arritjes zbërthehet në njësi përbërëse.

- Nëse ndërmjet burimit dhe caktit ekzistojnë më shumë rrugë të mundshme duhet zgjedhur përkatësen, nganjëherë vendimi mbi zgjedhjen bëhet në dy ose më shumë shtresa. P.sh nëse mesazhi duhet dërguar nga Prishtina në Vijen, zgjedhja se atë përdoret trasa përmes Kroacisë apo Hungarisë paraqet vendim të nivelit të lartë. Ndërsa vendim i nivelit të ultë paraqet zgjedhja se cila prej linjave në disponim në trasën e zgjedhur do të shfrytëzohet dhe zgjedhja varet nga angazhimi(ngarkimi) i këtyre linjave.

Funksioni i secilës shtresë është që të siguroj shërbim për shtresën mbi vetën. **Shërbimi** (ang. **Service**) është bashkësia e operacioneve të cilat shtresa e vëzhguar i kryen për shtresën mbi vete. Me fjalë të tjera, shërbimi definon se cilat operacione, shtresa e vëzhguar ka mundësi ti kryej në dobi të shfrytëzuesve të tij. Elementet aktive në secilën shtresë quhen **entitete**. Entiteti (ang. **entity**) softuerik (p.sh. procesi respektivisht përpunimi) ose harduerik (p.sh çipi hyrje-dalje). Etniteti në **shtresën n** i sigurojnë shërbime **shtresës n+1**. **Shtresa n** në këtë rast quhet **ofertues i shërbimit** (ang. **Service provider**), ndërsa **shtresa n+1** është shfrytëzuesi i shërbimit (ang. **Service user**). Për qëllim të kryerjes të shërbimeve të veta **shtesa n** mund të përdor shërbimet **eshtresë n-1**. Natyrisht se një shtresë mund ti kryen jo vetëm një shërbim por shumë lloje të shërbimeve (p.sh. Komunikacion të shpejtë të shtrenjtët ose të ngadalshëm por të lirë).

Entitetet përdorin protokolle (për të cilët kemi thënë se paraqesin bashkësi rregullash) për qëllim të realizimit të shërbimeve të paraparë. Protokollet të cilat i përdorin entitetet mund të ndërrojnë, por shërbimet të cilat entiteti i kryen nuk mund të ndërrojnë, këto duhet të qëndrojnë të pandryshuara.

Entitetet të cilët ndodhën në të njëjtën nivel (shtresë), por në kompjuterë tip ndryshëm janë **entitete të nivelit të njëjtë** (ang. **peer entities**)

Shtresa e lartë (**shtresa (n+1)**) mund t'u qaset shërbimeve të cilat i ofrojnë shtresa më ultë(**shtresa n**) në vende të caktuara në **shtresën n** e cila quhet pika për qasje të shërbimit (ang. **SAP- Service Access points**). Secila pikë qasje ka adresën e vetë e cila është e përcaktuar një kuptimit. P.sh në sistemin telefonik priza telefonike paraqet pikën për qasje të shërbimit, ndërsa numri telefonik i prizës parqet adresën të kësaj pike qaseshe.

Të theksojmë se shtresat e ultë të hierarkisë së protokolleve shpesh ndërtohen me harduer ose në softuer kontrollues.

Tani do të njihemi me dy **arkitektura të rrjetave** më të përhapura me realizimin e modelit **OSI** dhe me **TCP/IP**

2.5 MEDIUMET DHE STAFI I RRJETEVE KOMPJUTERIKE

Mediumi transmetues është pjesa e sistemit transmetues që ka për detyrë bartjen e sinjalit. Karakteristikat e mediumit transmetues ndikojnë shumë në cilësinë e transmetimit të sinjalit. Për transmetimin e të dhënave janë të rëndësishme këto veti themelore të medimeve transmetuese: gjerësia e brezit frekuencor, prej nga varet shpejtësia e transmetimit, distanca në të cilën mund të transmetohet sinjali, e mos të vije deri te humbja e informacionit, ndjeshmëria ndaj zhurmave. Mediumet transmetuese mund të ndahen në:

- medime të hapura dhe
- medime të mbyllura.

Secili medium i ka specifikat, përparësitë dhe mangësitë e veta.

Mediumet e hapura

Medium transmetues i hapur është ajri. Duke shfrytëzuar pikërisht këtë medium transmetues janë ndërtuar sistemet transmetuese, radio-rolle dhe ato satelitore. Mirëpo në këtë punim do të flasim kryesisht për mediumet e mbyllura apo mediumet fizike.

Mediumet transmetuese të mbyllura

Mediumet transmetuese të mbyllura janë: linjat transmetuese metalike dhe fija optike. Në linja metalike bëjnë pjesë: linja ajrore me dy përçues, linja telefonike (kabloja simetrike), kabloja UTP, STP dhe linja (kabloja) koaksiale. Brezi frekuencor dhe distanca e transmetimit të këto medime varet prej kapacitetit, induktivitetit dhe rezistencës omike të përçuesve, si dhe prej tipit të përçuesve. Rezistenca e dobëson sinjalin, ndërsa kapaciteti dhe induktiviteti ndikojnë në zhvendosjen fazore, përkatësisht në deformime. Shpejtësia e përhapjes së sinjalit nëpër këto medime është $v=2.108$ m/s.

Fija optike është mediumi më i ri dhe ka filluar të përdoret në fillim të viteve 70, dhe është ndër mediumet më të suksesshme deri me tani. Qoftë sa i përket dobësimit, distancës transmetuese, apo deformimeve tjera të sinjalit.

Në vijim do të paraqesim disa nga vetit kryesore të disa nga medimeve kryesore transmetuese të mbyllura.

Kabllo STP (Shielded twisted pair) - çiftet e telave të dredhur të izoluar

Kabllo STP është një kabull e cila përdoret për bartjen e të dhënave në distanca jo shumë të gjata. Është kabllo e përbërë prej 8 fijeve nga bakri të cilët dallohen ndërmjet tyre në bazë të ngjyrave të mbështjellëses së këtyre fijeve. Këto 8 fije të kabllos STP janë të grupuara në 4 grupe me nga 2 fije të përdredhura së bashku. Një kabllo e tillë është paraqitur në fig




Figure 7 STP - Shielded Twisted Pair

Specifikë e kësaj kabllo është se përbëhet prej 4 fijeve me 4 ngjyra të ndryshme, që janë pothuajse standarde, e ato janë: ngjyra e portokalltë, e gjelbër, e kaltër dhe ngjyra kafe, ndërsa fijet të cilat çiftëzohen me këto 4 fije “primare”, mbështjellësit e tyre i kanë ngjyrat: gjysmë portokalltë, gjysmë gjelbër, gjysmë kaltër dhe gjysmë kafe. Çdo çift i fijeve është i mbështjellur me folie metalike.

Të katër çiftet e fijeve janë përsëri të mbështjellura me një folie metalike të përbashkët. Kjo shtresë shërben për mbrojtjen e fijeve nga lagështia dhe interferencat e ndryshme. Në fig është paraqitur një kabllo STP e mbështjellur.




Figure 8 STP e mbeshtjellur

Përdredhja e përcjellësve ndihmon në reduktimin e interferencave që paraqiten te sinjalet që transmetohen nëpër këto fije. Sa më i përdredhur të jetë kabllo aq më rezistent është ndaj interferimeve dhe zhurmave të jashtme. Eliminimi i interferimeve (me vlera pozitive), apo zhurmave realizohet në atë mënyrë që zhurmat që paraqiten në pjesën pozitive eliminohen me ato që paraqiten në pjesën negative gjatë kalimit në pikën zero. Kjo mund të tregohet më mirë nëse e shikojmë fig.




Figure 9 Eliminimi i interfejseve

Përdorimi i kësaj kabloje varet nga:

- Raporti i përdredhjes.
- Numri i çifteve të përcjellësve.
- Cilësia e bakrit të përdorur.

- Tipi i mburojës që ka etj.

Kabllo STP zvogëlon zhurmën elektrike, interferencat magnetike dhe interferencat radiofonike.

Gjerësia maksimale e transmetimit të paketave të shënimeve me anën e këtij mediumi është 100 m, ndërsa gjerësia e brezit të transmetimit është 10-100Mbps.

Kabllo UTP (Unshielded Twisted Pair) - Çiftet e telave të dredhur të paizoluara

Kabllo UTP është i ngjashëm me kabllon STP, por me disa dallime të vogla, pasi që ky lloj mediumi është më i lehtë për t'u terminuar (instaluar) pasi që në këtë kabull ekziston vetëm një mbulesë dhe atë në pjesën e jashtme të të 4 çifteve të telave (shih figurën 1.6). Por për dallim nga kabllo STP, kabllo UTP është më pak imune sa i përket interferencave dhe dobësimit, prandaj kjo kabull përdoret kryesisht në ambientin e brendshëm të objektit e jo në bartjen e informacioneve nga objekti në objekt. Kablloja STP kryesisht për shkak izolimit që ka është mjaft imune ndaj interferimeve dhe dobësimeve që vinë nga ambienti, prandaj kryesisht përdoret në ambiente të jashtme, si p.sh. lidhja e pajisjeve nga një objekt në tjetrin.




Figure 10 UTP - Unshielded Twisted Pair

Edhe ky kabull ka gjatësinë e transmetimit deri në 100 metra, ndërsa brezin e transmetimit 10 – 100 Mbps. Konektori i cili duhet terminuar në këtë medium quhet konektori RJ-45. Duhet pasur kujdes gjatë terminimit sepse nëse e thyejmë kabllon nën kënd më të madh se 90 shkallë, mund të mos jetë funksional.

Avantazhet e kabllit UTP janë:

- Kabllit është më e lirë për tu mirëmbajtur dhe instaluar,
- Mund të përdoren me disa lloje të teknologjive, si: televizionet, kamerat, kompjuterët dhe telefonat.
- Mund të mbështet transmetimin e shumë sinjaleve nëpër kabllon e njëjtë, ndryshe prej kabllit koaksial.

Kabllit UTP është kabllit më e zakonshme që përdoret për krijimin e rrjetave kompjuterike lokale LAN. UTP gjithashtu ka gjetur përdorim në aplikacionet me video, kryesisht në kamerat e sigurisë.

Kabllit koaksial

Për dallim nga mediumet që u ceken më lartë, kabllit koaksial përbëhet prej një përçuesi të bakrit në mes, i cili është në formë të një cilindri të hollë dhe i cili pastaj është i mbuluar me një izolues plastik, e më pas përbëhet prej mbështjellësit të gërshetuar të bakrit i cili përdoret si përçuesi i dytë brenda këtij mediumi, dhe se të gjitha këto janë të izoluar me mbështjellësin e jashtëm. Një kabllit e tillë është paraqitur në fig.




Figure 11 Kabllit koaksial

Për shkak të izoluesit dhe mbrojtjes metalike kabllot koaksiale kanë një rezistencë mjaft të madhe ndaj interferencave dhe zhurmave të ndryshme që paraqiten si rezultat i faktorëve të ndryshëm.

Mund të transmetojë në një distancë më të madhe se sa kabllot UTP dhe STP, pa pasur nevojë të përdoren amplifikues, por në përgjithësi është një kablo e shtrenjtë, meqenëse kërkon shumë lëndë materiale në përgatitjen e tij.

Një e metë shumë e keqe është se nuk përballon një kapacitet të lartë për transmetim. Për ndërtim të rrjetave kompjuterike lokale, nuk është më i përdorshëm se sa kabllot UTP, sidomos jo në këto 10 vitet e fundit, pasi që kartelat e rrjetës me të cilat lidhet ky kablo nuk kanë shpejtësi të transmetimit të paketave më të madhe se 10 Mbps.

Një përparësi e këtij mediumi është se gjatësia e këtij kabllot mund të shkojë deri në 500 metra, gjë që e bën të përdorshëm kur kemi të bëjmë me lidhje të nryeve që janë në distanca më të mëdha. Konektori i cili duhet terminuar në këtë medium quhet konektori BNC.

Fijet optike

Fijet optike janë mediumet më bashkëkohore për transmetim. Fijet optike janë të tejdukshme me formë cilindrike dhe me diametër prej 2 deri $200 \cdot 10^{-6}$ m.

Fijet optike kryesisht janë të prodhuara prej qelqi, por ato mund të prodhohen edhe prej plastike. Si rezultat i humbjeve të vogla, brezit të gjerë të transmetimit, fijet optike mund të përdoren për transmetime në distanca shumë më të gjata se sa kabllot e bakrit; në rrjetet e të dhënave fijet optike mund të përdoren në një distancë rreth 50 km pa përdorur përsëritës. Peshë e tyre dhe madhësia e vogël i bënë fijet optike mjaft ideale për aplikim në krahasim me kabllot e bakrit, ku, me përdorimin e multipleksërëve, një fije optike mund të zëvendësojë me qindra kabllot bakri.

Kjo është një gjë shumë e mirë për një fije të hollë qelqi, por përfitim real në industrinë e të dhënave është imuniteti i fijos optike ndaj interferimeve elektromagnetike, dhe fakti që qelqi nuk është përçues elektrik. Në fig. është paraqitur forma e një kabllot me fije optike. Siç shihet, kabllot optike përbëhet nga bërthama (e cila mund të jetë nga qelqi ose plastika), mbështjellësja përreth bërthamës dhe nga një mbështjellëse e jashtme (nga plastika), e cila shërben si shtresë mbrojtëse për fijen.

Ndërmjet dy mbështjellësëve të fijos gjendet një rrjetë e përbërë nga fijet prej kevleri që shërbejnë për përforcim të fijos optike dhe e mbrojnë atë nga thyerjet.




Figure 12 Fijet optike

Fija optike mund të përdoret si medium për telekomunikime dhe rrjete, sepse fija optike është fleksibël dhe mund të lidhet si kablllo. Kjo është veçanërisht e dobishme për komunikimet në distanca të gjata, sepse drita përhapet nëpër fije me dobësim më të vogël në krahasim me kabllot elektrike. Kjo mundëson që të bëhet shtrirja në distanca më të gjata me një numër më të vogël të pajisjeve për përsëritje të sinjaleve.

2.6 TOPOLOGJIA E RRJETIT

Një rrjet kompjuterik është një grup kompjuterash autonomë të ndërlidhur me ndihmën e një teknologjie të caktuar. Dy kompjutera quhen të ndërlidhur nëse janë të aftë të shkëmbejnë informacion midis tyre. Lidhja mund të realizohet me anën e kabllave elektrikë, fibrave optike, mikrovalëve, rrezeve infra të kuqe apo me anën e satelitëve. Rrjetet kanë forma dhe madhësi të ndryshme.

Topologjia e rrjetit është model i lidhjeve të cilat lidhin çifte të nyjeve të rrjetit. Është formë e rrjetit LAN ose të ndonjë sistemi tjetër komunikues. Një nyje e dhënë ka një ose më shumë lidhje me tjera, dhe këto lidhje mund të shfaqen në shumëllojshmëri formash të ndryshme. Lidhja më e thjeshtë është lidhja e njëanshme mes dy njësive ose mjeteve. Lidhje e dytë mund të shtohet për komunikim të dyanshëm. Topologjia e rrjetit është e përcaktuar prej konfigurimit të lidhjeve mes nyjeve. Topologjitë e rrjetave janë të ndara në këto kategori themelore:

- Linare – (line)
- Magjistrallë – (bus)
- Yll – (star)
- Unazë – (ring)
- Dru – (tree)
- Mesh

Topologjia fizike

Topologjia fizike është shtrirja fizike e komponentëve në një rrjetë kompjuterike

Topologjia logjike

Topologjia logjike determinon se si hostat qasen në medium që të komunikojnë në rrjetën kompjuterike

2.6.1 Topologjia Lineare

Topologjia lineare krijon lidhje të dyanshme në mes një kompjuteri dhe kompjuterit të ardhshëm. Kjo përvojë është nga fillimi i kompjuterëve, pasi që secili kompjuter, përveç atyre në fillim dhe fund, kërkon dy pranues dhe dy transmetues.



Figure 13 Topologjia lineare

2.6.2 Topologjia Magjistrale

Topologjia magjistralë karakterizohet me bartjen kryesore që paraqet shtyllën e rrjetës ku janë të lidhur kompjuterët. Kjo topologji llogaritet pasive sepse kompjuterët e lidhur në magjistralë vetëm „vëzhgojnë“ çka ndodh në të. Kur e vërejnë përmes kartelës së rrjetit se të dhënat janë drejtuar kah ato atëherë këto të dhëna i pranojnë. Kur kompjuteri është i përgatitur për të dhënë informata, ai në fillim vërtetohet se asnjë kompjuter tjetër nuk dërgon të dhëna në magjistralë, dhe atëherë i dërgon paket e informacioneve të tij .Në rrjetë si magjistralë më shpesh shfrytëzohet kablllo koaksial. (ky kabëll shumë pak dallohet prej kabllos së TV të rëndomtë).Rrjetat me topologji magjistralë lehtë lidhen dhe zgjerohen në krahasim me topologjitë tjera ato kërkojnë sasi të caktuar të kabllove. Në rrjetat me topologji magjistrale janë të shpeshta ndërprerjet kablloviqe ku vështirë mund të zbulohen. Nëse një konektor hiqet bien e gjithë rrjeta. Këto rrjeta sot përdoren më rrallë të mbetura nga e kaluara. Në figurë duket topologjia magjistralë.




Figure 14 Topologjia magjistrale

2.6.3 Topologjia Star

Në topologjinë yll kompjuterët janë të lidhur me pajisje qendrore për lidhje i cili quhet shpërndarës. Secili kompjuter është i lidhur me kabllon e veçantë deri në shpërndarës. Për arsye se për secilin kompjuter të lidhur ekziston kablllo e veçantë dhe portë e veçantë për lidhje ,shumë lehtë mund rrjeta edhe të zgjerohet. Kufizim mund të jetë vetëm numri i hyrjeve në shpërndarës. Nëse një kompjuter ç'kyçet kompjuterët tjerë mund të punojnë pa problem në mes veti. Pjesa më e ndjeshme është shpërndarësi qendror. Në topologjinë yll shpërndarësi shërben si pikë e lidhjes qendrore si që shihet në figurë.




Figure 15 Topologjia Yll

2.6.4 Topologjia Tree

Topologjia tree (formë druri) mund të shihet si nj koleksion i rrjetave yll të vendosura në hierarki. Ky rregullim në formë druri ka nyje periferike individuale të cilat kanë detyrë të pranojnë dhe transmetojnë vetëm prej nyjeve dhe nuk kërkohen të jenë si repetitorë apo regjeneratorë. Në dallim prej topologjisë yll nyja qendrore mund të shpërndalet.

Si në rrjetin konvencional yll, nyje individuale mund të izoloohen prej rrjetit me një defekt të vetëm të një pike të vetme transmetuese. Në qoftë se një lidhje me gjethin e rrjetit në formë druri dështon, ai gjeth (leaf) izolohelet; në qoftë se një lidhje me nyje e cila nuk është gjeth dështon, një sektor i tërë i rrjetit izolohelet prej pjesës tjetër.

Për ta lehtësuar sasinë e trafikut të dhënave që vjen nga transmetimi i çfarëdo të dhëne dhe nga cilido vend, janë krijuar nyje më të përparuara që do të mbajnë llogari për identitetin e sistemeve të ndryshme të lidhura në rrjet. Këto Switch-a rrjeti do ta mësojnë bazën e rrjetit duke transmetuar të paketa të dhënash gjithandej e pastaj duke vëzhguar prej nga vijnë përgjigjet paketë.




Figure 16 Topologjia Tree

2.6.5 Topologjia Unazë

Në **topologjinë unazë** kompjuterët lidhen me kablllo në rend dhe formojnë rreth fizik. Në këtë topologji informacioni udhëton kah përçuesit (kabllot) në një drejtim. Kompjuterët në unazë pranojnë paketë dhe pastaj të njëjtën paketë e dërgojnë te kompjuteri tjetër në rrjetin unazë. Topologjia unazë llogaritet aktive sepse kompjuterët e lidhur në unazë dërgojnë token nëpër gjatësinë e unazës. Token është paketë e veçantë e të dhënave.

Gjetja e defektit në topologjinë unazë është mjaft e vështirë sepse me prishjen e një kompjuteri në rrjetë ndërpritet rrjedhja e informatave në unazë dhe kështu nuk dimë ku është ndërprerja. Futjen dhe heqjen e kompjuterit të ri në rrjetë bënë ndërprerje të punës së rrjetës. Për arsye se hardueri për Token ring është i shtrenjtë dhe për mirëmbajtjen e kësaj rrjete duhet administratorë me përvojë të madhe këto rrjeta përdoren vetëm në firmat e fuqishme e jo në rrjeta lokale shtëpiake. Për rrjeta lokale në zyra dhe shtëpi më e përshtatshme është rrjeta në




Figure 17 Topologjia Unaze

2.6.6 Topologjia Hibride

Rrjetat hibride përdorin kombinimin e dy ose më shumë topologjive në atë mënyrë që rezulton që rrjeti nuk e ka asnjë nga format standarde.

Dy shembuj më të shpeshtë të rrjetave hibride janë:

- Rrjeti yll-unazë (star ring) përbëhet nga sy ose më shumë topologji yll të lidhura me (MAU) multistation acces unit si HUB qendror
- Rrjeti yll-magjistralë (star-bus) përbëhet nga dy ose më shumë topologji yll të lidhura me (bus trunk).




Figure 18 Topologjia Hibride

2.6.7 Topologjia Tërësisht e lidhur

Tërësisht të lidhur (kyçur) nënkuptohet topologjia në të cilën të gjithë kompjuterët e atij rrjeti janë të lidhur secili me njëri tjetrin dhe kalimi i informatave bëhet drejtpërdrejt pa ndërmjetësim.




Figure 19 Topologjia teresisht e lidhur

2.7 Ndërlidhja e objekteve ndërmjet veti me Virtual Private Network

2.7.1 VPN

VPN është shkurtesë nga gjuha angleze e fjalëve Virtual Private Network të cilat në përkthim të lirë kanë domethënie e rrjetës private virtuale.

Një VPN rrjetë e zakonshme mund të ketë një LAN rrjetë kryesore në zyrat qendrore të kompanisë, LAN rrjete tjera në zyrat ose objektet në largësi dhe shfrytëzues individual që lidhen në rrjetë nga terreni. Parimisht, një VPN është rrjetë private që përdorë rrjetën publike (zakonisht Internetin) për t'u lidhur me pikat ose shfrytëzuesit në largësi. Në vend të përdorimit të linjave të huazuara të dedikuara, VPN përdorë linja "virtuale" të kanalizuar nëpër internet prej rrjetës private të kompanisë deri te pika ose punëtorët në largësi.

